

## Përkrahja politike rajonale

Nismës për KOMRA-n i është dhënë përkrahja deklarative politike e përfaqësuesve më të lartë të pushtetit dhe të partive politike. Themelimi i KOMRA-s e kanë përkrahur edhe kryetarët e Kroacisë, të Malit të Zi dhe të Sllovenisë, Ivo Josipović, Filip Vujanović dhe Danilo Türk, anëtarë të Kryesisë së Bosnjës e Hercegovinës, Zhejko Komšić, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, një numër i madh i ministrave, kryetarët e partive politike më të mëdha parlamentare si dhe përfaqësuesit e një numri të madh të institucioneve shtetërore vendore.

## Avokuesit publik të Nismës KOMRA

Detyra e tyre është t'i bindin politikanët vendor që së bashku ta themelojnë KOMRA-n e, me këtë, të tregojnë se janë të vendosur në bashkëpunimin rajonal mbi bazën e fakteve dhe të dialogut lidhur me atë se çfarë ka ndodhur në të kaluarën.

Zdravko Grebo, profesor në Fakultetin Juridik në Sarajevë, BeH  
Zharko Puhovski, profesor në Fakultetin Filozofik në Zagreb, Kroaci  
Biljana Vankovska, profesore në Fakultetin Filozofik në Shkup, Maqedoni  
Dino Mustafić, regjisor, BeH  
Adriatik Kelmendi, gazetar, Kosovë  
Dinko Gruhonjić, gazetar, Serbi  
Dushko Vuković, gazetar, Mali i Zi  
Xhenana Karup Drushko, gazetare, BeH  
Igor Mekina, gazetar, Slloveni  
Natasha Kandiq, mbrojtëse e të drejtave të njeriut, Serbi

## Fushata KOMRA për të ardhmen

Është koha për vendim politik.

Është koha për një hap të ri.

Vendoseni vulën shtetërore.

KOMRA për të ardhmen.

Koalicioni për KOMRA-n iu drejtohet politikanëve, duke e kërkuar konkretizimin e përkrahjes së tyre si dhe që ata të fillojnë procedurat në mënyrë që Nisma KOMRA të bëhet projekt ndërshtetëror i pajtimit.

Informatat mbi aktivitetet e Koalicionit për KOMRA-n janë të qasshme në faqen e Nismës në Internet, [www.zarekom.org](http://www.zarekom.org) dhe [www.perkomra.org](http://www.perkomra.org), në gjuhën shqipe, boshnjake, malaziasë, angleze, kroate, maqedonase, sllovene dhe serbe.

Në rrjetin social Facebook në adresën

Za rekom Për komra For recom e zhvillojmë fushatën për KOMRA-n.

Bashkohuni me ne.

Rajonal (KOMRA)

publikisht

tjera të reja

Jugosllave

# Koha është për vendim.

# KOMRA për të ardhmen.

# Që të mos përsëritet.

# Vreme je za odluku.

# Čas je za odločitev.

# Bëj diçka për veten tënde dhe të tjerët.



KOMRA

## Koha është për KOMRA-n

Nisma për KOMRA është rajonale dhe e bazuar në dialogun e hapur. Është rruga drejt njohjes së gjithmbarshme historike të krimeve të cilat janë kryer në të kaluarën e afërt. Udhëheqë me konstatimin e rolit të elitave nacionale, institucioneve dhe individëve në shkeljet e drejtave të njeriut.

Gjykimet para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe para gjykatave vendore në masë të madhe i kontribuojnë denimit të kryerësve të krimeve por nuk janë në gjendje që në masë të plotë të kënaqin nevojat e viktimave dhe shoqërive për drejtësi e as që mundën të vetme të sigurojnë kushte për arritjen e paqes së qëndrueshme në regjion.

Është e nevojshme bashkëndjesi me viktimat e të gjitha popujve në territorin e ish-RSFJ-së. Keqpërdorimi i viktimave për qëllime politike dhe garimin në viktimizim duhet të kundërshtohen me fakte.

KOMRA ka mundësinë që në mënyrë të vendosur të kontribuojë në pranimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të drejtave të njeriut të të gjitha viktimave. Me këtë vendoset bazë për përtëritjen e besimit në mes të individëve, popujve dhe shteteve në regjion.

Ekzistimi i KOMRA-s nxitë solidaritetin me familjet e të zhdukurve në tentimin e tyre që të dijnë fatin dhe të gjejnë mbetjet mortore të më të afërme të tyre.

## Çfarë është KOMRA

Komisioni regional ndërshtetëror, KOMRA, konstaton dhe i bënë publike faktet për të gjitha viktimat e luftërave të viteve 1991-2001 në hapësirën e ish-RSFJ-së gjatë tre viteve nga themelimi.

KOMRA është trupë jashtëqyqësor e cila konstaton fakte në lidhje me gjenocidin, krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut dhe nuk sjell vlerësime juridike.

Komisioni konstaton faktet mbi rrethanat politiko-shoqërore të cilat kanë qenë vendimtare në shpërthimin e luftërave dhe krimeve të luftës.

Është obligim i Komisionit që ta krijojë listën emër për emër të të gjitha viktimave civile, të ushtarëve, të policëve dhe të pjesëtarëve të tjerë të formacioneve të armatosua dhe të vërtetë të gjitha faktet relevante dhe rrethanat e vrasjes së tyre.

KOMRA është i obliguar të mblledhë të dhënat në lidhje me vendet e burgosjes gjatë dhe në lidhje me luftën. Do të përgatisë një regjistrim të gjithanshëm të atyre që janë burgosur në mënyrë jashtëligjore, viktimat e torturave dhe trajtimit çnjerëzor.

Komisioni është trupë hulumtuese e cila është e autorizuar që të marrë dëshmi nga gjithë ata që mund të ofrojnë informata relevante mbi krimet e luftës. I thërrer individët në emër të saj apo edhe si përfaqësues të institucioneve, grupeve politike, bashkësive fetare, shoqatave profesionale dhe mediave të dëshmojnë para Komisionit.

Një Komision i tillë mund të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në shtetet post-jugosllave të pranojnë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut. Kjo trupë hulumtuese në bashkëpunim me komisionet zyrtare për persona të zhdukur marrin pjesë në ndriçimin e fatit të të zhdukurve të ndërlidhur me luftërat. KOMRA jep rekomandime për dëshmipërblimet materiale, kërkimfaljet, ngritjet e përmendoreve, qendrave memoriale dhe shënjimin e vendeve të rënies.

## Koalicioni për KOMRA-n

Koalicioni për KOMRA-n është rrjet rajonal i shoqërisë civile që avokon themelimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin dhe kumtimin publik të fakteve mbi krimet e luftës, të cilat janë kryer në territorin e ish-RSFJ-së nga muaji janar i vitit 1991 deri në fund të vitit 2001. E përbëjnë 1.800 organizata dhe individë, duke përfshirë organizata për të drejtat e njeriut, shoqatat e viktimave, organizatat rinore, shoqatat e veteranëve, media, bashkësitë fetare, anëtarë të familjeve të viktimave dhe persona të cilët në mënyrë aktive promovojnë ballafaqimin me të kaluarën. Detyra themelore e Koalicionit për KOMRA-n është të përforcojë përkrahjen publike e mediatike për shoqërinë civile lidhur me themelimin e KOMRA-s.

## Propozim Statuti i KOMRA-s

Në periudhën nga muaji maj i vitit 2006 e deri në muajin mars të vitit 2011, Koalicioni për KOMRA-n ka organizuar 128 takime konsultative mbi detyrat, objektivat dhe aktivitetet e Komisionit Rajonal. Në këto konsultime kanë marrë pjesë rreth 6.500 përfaqësues të shoqërisë civile dhe 65 anëtarë të bashkësisë juridike. Në bazë të propozimit të pjesëmarrësve të procesit konsultativ dhe duke pasur parasysh zgjidhjet e mira të komisioneve të suksesshme për të vërtetën, Grupi i Punës për përpunimin e modelit të KOMRA-s e ka bërë projekt propozimit të Statutit të KOMRA-s, i cili është i harmonizuar dhe i miratuar në Kuwendin e Katërt të Koalicionit për KOMRA-n në datën 26 mars të vitit 2011. Me këtë është bërë Propozim i Statutit të Komisionit Rajonal [KOMRA]. Koalicioni kërre ua ka drejtuar të gjithë kryetarëve në territorin e ish-RSFJ-së duke iu bërë atyre thirrje që, në interesin e viktimave dhe të gjeneratave të ardhshme bashkërisht të formojnë KOMRA-n, që mund të sigurojë pranimin dhe respektin publik të të gjitha viktimave.

## 543. 870 nënshkrime të përkrahjes

Nga data 6 prill e deri në datën 30 qershor të vitit 2011, 450 vullnetarë, në 15 qytete në Bosnjë e Hercegovinë, në Mal të Zi, në Kroaci, në Kosovë, në Maqedoni, në Slloveni dhe në Serbi, kanë mblledhur nënshkrimet e qytetarëve për themelimin e KOMRA-s. Gjithsejtë i kanë marrë 543.870 nënshkrime të përkrahjes, që përbënë deri tash përkrahjen më të madhe që i është dhënë ndonjë iniciative civile si dhe që, po ashtu, përbënë tubimin e parë të qytetarëve të vendeve post-jugosllave rreth një nisme të përbashkët. Befasia më e madhe në fushatë është përkrahja e madhe e qytetarëve (46.000) në Banja Llukë. Vullnetarët, gjatë tri javëve, në Kosovë i kanë mblledhur 100.000 nënshkrime. Në Serbi janë mblledhur 254.625 nënshkrime, në Kroaci 19.874, në Mal të Zi 31.060, në Slloveni 5.346, dhe në Maqedoni 10.059 nënshkrime.

## Përkrahja ndërkombëtare

Përkrahja e parë ka ardhur nga Nën-komiteti për të Drejtat e Njeriut i Parlamentit Evropian në datën 30 shtator të vitit 2009. Me atë rast, kryetarja e Nën-komitetit, zonja Heidi Hautala ka vlerësuar „se kjo është hera e parë që një iniciativë, kështu e rëndësishme, vjen nga poshtë drejt nësh“. Në Rezolutë, të miratuar në datën 19 janar të vitit 2011, Parlamenti Evropian ka përkrahur Nismën KOMRA si proces të ngritjes së ndërgjegjes dhe të pajtimit anë e kënd Ballkanit Perëndimor dhe i ka ftuar qeveritë e ish Jugosllavisë që t'i ofrojnë mbështetje asaj nisme civile.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, në datën 26 janar të vitit 2011 e ka miratuar Rezolutën, me anë të së cilës posaçërisht është e theksuar mbështetja për Nismën KOMRA, e cila bënë ftesë për pranimin dhe respektimin publik të të gjitha viktimave.

Komisioni Evropian në raportin mbi progresin në integrimet evropiane ka vlerësuar se „Nisma të organizatave joqeveritare dhe të shoqërisë civile, siç është KOMRA, luajnë një rol të rëndësishëm në përfundimin e pajtimit midis qytetarëve të rajonit“. Zyra për të Drejtat e Njeriut e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në takim me përfaqësuesit e Koalicionit për KOMRA-n në datën 15 nëntor të vitit 2011, ka dhënë përkrahjen e padiskutueshme të Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut për Nismën për themelimin e KOMRA-s. Përkrahje të fuqishme Nismës për themelimin e KOMRA-s i ka dhënë edhe Zyra Rajonale e UNDP-së (Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara-PZhKB) për Evropë dhe Bashkimin e shteteve të pavarura, në takimin me delegacionin e Koalicionit për KOMRA-n në datën 16 nëntor të vitit 2011. Ai ka theksuar gatishmërinë e UNDP-së që praninë e saj në vendet post-jugosllave ta shfrytëzojë për avokimin e themelimit të KOMRA-s.

Me rastin e përfaqësimit të raportit „Drejtësia e pasluftës dhe pagja e qëndrueshme në ish Jugosllavinë“, në datën 19 mars të vitit 2012 në Sarajevë, Komisionari për të drejtat e njeriut i Këshillit të Evropës, Thomas Hammarberg edhe njëherë e ka përkrahur themelimin e KOMRA-s. Ai ka apeluar tek elitat politike që sa më parë të fillojnë diskutimin serioz mbi KOMRA-n. Ai ka theksuar rëndësinë e ekzistimit të një narrativi të përbashkët dhe konsensusi mbi faktet thelbësore si dhe ka përhëndetur fokusimin e KOMRA-s pikërisht në procesin e vërtetimit të fakteve.

Sipas fjalëve të Hammarbergut, një konsensus i tillë nuk e përjashton respektimin dhe të kuptuarit e versioneve të ndryshme të së vërtetës, të cilat i ka secila bashkësi etnike në veçanti, sepse edhe kjo është një nga aspektet e pajtimit, por duhet të ekzistojë qëndrimi i përbashkët mbi faktet kyçe të lidhura me ngjarjet e luftës të viteve nëntëdhjetë. Parlamenti Evropian, në datën 29 mars të vitit 2012, ka miratuar Rezolutën mbi përparimin e Serbisë (2011/2886 RSP), dokument të cilin e ka përgatitur deputeti slloven Jelko Kacin. Në pikën 39 të Rezolutës, Parlamenti Evropian „shpreh përkrahjen për nismën KOMRA me qëllim që edhe më tutje ta drejtojë dhe oriento procesin e pajtimit në tërë Ballkanin Perëndimor. Kryeprokurori i TPNJ Serge Brammertz, me rastin e vizitës së tij Republikës së Kroacisë në datën 1 prill të vitit 2012 e ka përhëndetur nismën rajonale për vërtetimin dhe tregimin e së vërtetës.